

Prizren: Rezultate më të mira në provimin e maturës

Maturantët e 5 shkollave të mesme të Prizrenit, këtë vit kanë shënuar sukses më të mirë në provimet e diplomës. Nexhat Çoçaj, koordinator pranë Drejtorisë Komunale për Arsim ka thënë të martën se suksesi që kanë treguar maturantët prizrenas në provimin shtetëror të maturës është më i mirë se sa ai në vitin e kaluar, mirëpo, dëshira jonë ishte që ky rezultat të jetë edhe më i lartë.

"Provimit të maturës këtë vit në të gjitha shkollat e mesme të komunës së Prizrenit, iu janë nënshtruar gjithsejtë 2162 nxënës, të cilët provimit i janë nënshtruar në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Nga ky numër, 1145 apo 52.96 për qind kanë treguar sukses pozitiv, ndërsa 1017 apo 47,04 për qind kishin rezultate negative. Prej numrit të përgjithshëm, 1864 nxënës kanë hyrë në provime në gjuhën shqipe, ku kalueshmëria ishte 51.23 për qind, 162 nxënës provimin e dhanë në gjuhën boshnjake, ku rezultati pozitiv ishte 69.55 dhe 136 nxënës, të cilët provimet i kishin në gjuhën turke dhe shënuan rezultat pozitiv 57.35", ka thënë Çoçaj, ndërkaq që drejtori për Arsim dhe Shkencë, Florim Metaj, ka theksuar se në Gjinnazin nr 1 në Prizren kalueshmërinë e ka pasur 90 për qind, por shkallë të këtyllë nuk kishin edhe maturantët e paraleleve të ndara të gjinnazit në Zym ku atje asnjëri nga maturantët nuk e ka dhënë provimin e maturës, pastaj në paralelet e Velezhës, ku provimin e ka dhënë vetëm një nxënës, në Gjonaj 4 dhe në paralelet e Romajës 5 maturantë. Ndërkaq, sa i përket rezultateve në secilën shkollë veç e veç, suksesi më i mirë është arrit-

ur në Shkollën e Mesme të Mjekësisë me sukses pozitiv prej 63 për qind dhe në Shkollën Ekonomike me rezultat prej 43.6 për qind, ndërsa rezultat më të ultë kanë arritur nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike me vetëm 17.87 për qind, ka thënë Metaj.

Një sihariq të mirë, për sa i përket rezultateve në provime, në Prizren ka arritur edhe nga Gjermania, ku nxënësit e Gjinnazit "Loyola" nga Prizreni kanë shënuar rezultate të shkëlqyeshme në provimin e diplomës. Në një komunikatë të lëshuar për media nga

ky gjinnaz, thuhet se nxënësit dhe nxënëset e Gjinnazit "Loyola" në Prizren morën pjesë për herë të parë në këtë vit në provimin e diplomës së gjuhës gjermane, i cili mbahet nën përkujdesjen e Konferencës Gjermane të Ministrave të Kulturës. Bëhet fjalë për një provim, i cili është përpiluar në Gjermani, rezultatet e të cilit shqyrtohen po atje. "Këtij provimi i nënshtrohen çdo vit rreth 17.000 nxënës nga e mbarë bota. Kalimi me sukses i këtij provimi, nga aspekti gjuhësor është kusht, që pas përfundimit të shkollimit të mesëm nxënësit dhe nxënëset e huaja të mund të fillojnë studimet në Universitete të ndryshme në Gjermani. Njëzet e një nxënës të Gjinnazit të cilët e kanë kaluar provimin këtë vit, kanë arritur suksese të shkëlqyeshme", kanë thënë të martën zyrtarë të kësaj shkolle, duke shtuar se të mërkurën para dite ambasadori gjerman në Kosovë, Hans-Dieter Steinbach do t'ua shpërndajë certifikatat e diplomave nxënësve të kësaj shkolle.

R. Reshitaj